



NR 7912 PROT  
DATE 11.11.2015

KANDITAT I PAVARUR  
“GJERGJ ALEKSANDER BOJAXHI”  
TIRANE

**RAPORTI I EKSPERTIT KONTABËL TE REGJISTRUAR**

Per Auditimin Ligjor

të Fondeve të Përfituara dhe Shpenzimet e Kryera  
për Fushatën Zgjedhore per Organet e Qeverisjes Vendore  
te Dates 21.06.2015

Tirane, Nentor 2015

**RAPORTI I AUDITUESIT TE PAVAU**

Drejtuar : -Komisionit Qendror te Zgjedhjeve  
(Pallati i Kongreseve)

Tirane

-Z. Gjergj Aleksander BOJAXHI  
(Rr. "Papa Gjon Pali" ETC,A/13/1 ")

Tirane

Te Nderuar Zoterinj:

Bazuar ne Ligjin 10019 date 29/12/2008 “Kodi Zgjedhor i Republikes se Shqiperise” i ndryshuar, ne zbatim te vendimit te KQZ Nr. 969 date 10/08/2015 si dhe kontraten e sherbimit Nr.7686 date 25/09/2015 te lidhur me kete institucion ne cilësinë e ekspertit kontabël të regjistruar kemi audituar pasqyrat financiare bashkelidhur që lidhen me financimin e fondeve të përfituara dhe të shpenzuara për fushaten zgjedhore, per zgjedhjet per Organet e Qeverisjes Vendore te dates 21.06.2015 nga kandidati i pavarur Gjergj Aleksander BOJAXHI.

*Pergjegjësia per Pasqyrat Financiare*

Pergatitja e pasqyrave financiare per fondet e perfituara dhe shpenzuara gjate fushates zgjedhore per organet e qeverisjes vendore te 21 qershorit 2015, eshte e kandidatit z. Gjergj Aleksander BOJAXHI.

*Pergjegjësia e Audituesit*

Pergjegjësia e jone eshte qe bazuar ne auditimin e kryer, te shprehim nje opinion mbi keto pasqyra financiare. Auditimin e kemi kryer ne pajtim me Standartet Nderkombetare te Auditimit, referencë të vecantë me SNA 800. Keto standarte kerkojne qe ne te jemi ne perputhje me kerkesat e etikes dhe qe te planifikohet dhe te kryhet auditimi per te marre sigurine e arsyeshme qe pasqyrat financiare nuk permbajne anomali dhe gabime materiale. Auditimi përfshin shqyrtimin, mbi bazen e testeve, të fakteve që mbështesin shumat dhe deklarimet në pasqyrat financiare që përfshijnë: Librin e llogarive të subjektit, regjistrin e posaçëm të miratuar si model si dhe pasqyrën e arketim pagesave. Auditimi përfshin gjithashtu, vlersimin e parimeve të kontabilitetit të ndjekura dhe vlersimet e rëndësishme të bëra nga drejtimi, si edhe vlerësimin e paraqitjes së përgjithshme të pasqyrës.

Ne çmojme se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë të auditimit.

Pasqyrat bashkelidhur te fondeve të përfituara dhe të shpenzuara për fushatën zgjedhore të Kandidatit te Pavarur Gjergj Aleksander Bojaxhi per zgjedhjet per Organet e Qeverisjes Vendore te dates 21.06.2015 jane përgatitur në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kërkesat e raportimit financiar mbi bazën e arkëtimit dhe të pagesave, konform ligjit nr.9228 dt.29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

*Opinion*

Sipas opinionit tone, bazuar ne auditimin e kryer, me siguri te aresyeshme, shprehim opinionin se Pasqyrat Financiare te fondeve të përfituara dhe të shpenzuara për fushatën zgjedhore të Kandidatit te Pavarur Gjergj Aleksander Bojaxhi per zgjedhjet per Organet e Qeverisjes Vendore te dates 21.06.2015 , japin nje pamje te vertete dhe te sinqerte.

Per “LIRENG Auditing” Shpk

Neshat MAZE

  
Ekspert Kontabël i Regjistruar

Lic.148. date 21/07/2006



Tirane, Nentor 2015

## *I - INFORMACIONE TË PËRGJITHSHME*

Baza ligjore per kryerjen e ketij misioni është marrë në referim të ligjeve:

- Ligjit nr 10019 date 29.12.2008 dhe ndryshuar me ligjin nr 74/2012 date 19.07.2012 dhe ligjin nr 31/2015 date 02.04.2015 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”.
- Ligji nr.10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të Ekspertit Kontabël të Regjistruar dhe të Kontabilistit të Miratuar”, Standartet Ndërkombetare të auditimit dhe kryesisht (SNA 800).
- Ligji Nr. 9228 date 29.04.2004 “Per Kontabilitetin dhe Pasqyrat Finnciare”
- Çdo dokument ligjor të marrë prane Kandidatit te Pavarur Gjergj Aleksander BOJAXHI.

### *TË DHËNA TË PËRGJITHSHME MBI SUBJEKTIN ZGJEDHOR*

Gjergj Aleksander BOJAXHI eshte regjistruar si kandidat per kryetar bashkie ne qytetin e Tiranës.

Burimet e financimit jane:

- Burimet e veta
- Te ardhurat nga kontributet vullnetare;
- Nga donacionet,dhurimet brenda vendit.

Politikat operuese

Kandidati i Pavarur Gjergj Aleksander Bojaxhi, ka operuar per kete periudhe qe auditojme ne, ne pajtim me ligjin 10019, date 29.12.2009 “Kodi zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” dhe ligjin Nr.9228 “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare” i dates 29.04.2004.

Te ardhurat Financiare te Kandidatit te Pavarur Gjergj Aleksander Bojaxhi perbehen nga burimet e veta, kontribute vullnetare te qytetareve, dhurime,donacione te qytetareve te ndryshem, etj.

### *PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE DHE RREGULLAVE KRYESORE KONTABEL*

#### *Organizimi i Kontabilitetit*

Kontabiliteti është i organizuar në përputhje me ligjin “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat financiare”. Kandidati i Pavarur Gjergj Aleksander Bojaxhi ka ndertuar nje plan të llogarive vetjake në përputhje të plote me Planin Unik Kontabël. Kontabiliteti mbahet në menyre manuale.

*Pasqyra e te Ardhurave dhe Shpenzimeve,*

- A. Te ardhura te perfituara ne shumen 2,625,452.00 Leke , te perbera nga :
- Nga buxheti i shtetit sipas ligjit per financimin e partive politike.....0 Leke
  - Burimet e veta.....100,000 Leke
  - Kontribute vullnetare nga qytetaret .....1,166,534 Leke
  - Dhurime vullnetare nga qytetaret.. ..... 1,046,304 Leke



## “LIRENG Auditing sh p k.

- Donacione nga qytetaret dhe bizneset ..... 312,614 Leke

Nga auditimi rezultoi se Të ardhurat e siguruara nga Kandidati i Pavarur Gjergj Aleksander Bojaxhi për të përbulluar fushatën e zgjedhjeve për zgjedhjet për Organet e Qeverisjes Vendore të datës 21.06.2015 janë deklaruar gjithsej 2,625,452.00 Leke. Këto të ardhura janë krijuar nga të ardhura të tjera si kontribute vullnetare të qytetarëve, dhurime, donacione të qytetarëve të ndryshëm, etj, siç parashikohet në nenin 87 e në vijim të Ligji nr.10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”.

B. Te shpenzuara në shumen 1,830,800.00 Leke , te perbera nga :

- Karburant..... 109,450 Leke
- Kancelari .....50,226 Leke
- Likujdim postera,fletevolante,fletpalosje .....615,170 Leke
- Internet... ..84,000 Leke
- Shpenzime të tjera(ushqim,kafe,taksi,kamera etje).....971,954 Leke

C. Gjendje mjete monetare të pa shpenzuara në shumen 794,584.00 Leke pranë bankës Banka Kombëtare Tregtare dhe Raiffaisen Bank :

Shpenzimet e fushatës të Kandidatit të Pavarur Gjergj Aleksander Bojaxhi për zgjedhjet e 21 Qershorit 2015 janë deklaruar gjithsej 1,830,800.00 Leke,dhe përbehen nga shpenzimet për likujdim faturash,blerja karburanti,intenet,kancelari,koktejt,ushqim-kafe,taksi,kameraman, fotograf,komisione banker e të tjera të dokumentuara dhe të njohura si shpenzim,te likujduar nëpërmjet bankës dhe arkës.

*Gendja e Likujditeteve:*

Në mbyllje të fushatës zgjedhore gjendja e likujditeve në llogaritë bankare dhe në arke, për ato të çelura vetëm për fushatën është 636,584.00 Leke të Banka Kombëtare Tregtare dhe 158,000 leke të Raiffaisen Bank,pra gjithsej 794,584.00 leke,te dokumentuara me ekstraktet bankare të bankave.

Per “LIRENG Auditing” Shpk

Neshat MAZE

Ekspert Kontabël Regjistruar



Tirane, Nentor 2015

## DEKLARATE

Pasi u njohem me Vendimin e Komisionit Qendror te Zgjedhjeve Nr. 969 date 10.08.2015, per Auditimin e Fondeve te Perfituara dhe Shpenzuar nga Subjektet Zgjedhore per Fushaten per Zgjedhjet per Organet e Qeverisjes Vendore te dates 21.06.2015,

### DEKLAROJ

Une kandidati i pavarur Gjergj Aleksander BOJAXHI ne zbatim te dispozites ligjore te Ligjit 10019 date 29/12/2008 i ndryshuar "Kodi Zgjedhor i Republikes se Shqiperise" per Zgjedhjet per Organet e Qeverisjes Vendore te dates 21.06.2015 deklaroj se kam marre vetem kontribute sponsorizimi, dhurimi e te tjera siç parashikohet nga Ligji i mesiperm. Kandidati i pavarur Gjergj Aleksander BOJAXHI ka keto te ardhura dhe shpenzime per Fushaten e 21 Qershor 2015.

#### **Te Ardhurat**

Nr	Burimet e perfitimit te fondeve gjate fushates zgjedhore per organet e qeverisjes vendore te 21 qershorit 2015	Vendi i depoziti mit	Lloji i monedhes			Kursi	Total ne leke
			Leke	Usd	Ne natyre		
I	Buxheti i shtetit	S'ka				0	
II	Burimet e veta	Arke	100.00 0			100.000	
III	Sponsorizimet	BKT				1.251.953	
	Sponsorizimet	RFZ	158.00 0			158.000	
	Sponsorizimet	ARKE	1.115. 499			1.115.499	
IV	Te ardhura nga anetaresia e keshillit te qarkut	S'ka				0	
V	Interesa bankare	S'ka				0	
	Totali					2.625.452	

## Shpenzimet

Nr	Emertimi i shpenzimeve	Shenime	Menyra e kryerjes se pageses	Totali i shpenzimeve
1	Marrje salla me qera		Donacion	0
2	Reklam televizive			0
3	Reklam ne radio			0
4	Sherbime telefonike		Arke	84.000
5	Shpenzime per postera ,fletevolante,fleteplosje		Banke	615.170
6	Kancelari		Arke	50.226
7	karburant		Arke	109.450
8	Te tjera		Arke	971.954
	Totali			1.830.800

Gjendja e mjeteve te tepruara nga fushat eshte ne shumen 794.584,20 Leke.

Kete Deklarate ja paraqesim ekspertit kontabel te regjistruar Neshat Maze, i cili eshte caktuar te kryej auditimin e fondeve te perftuara dhe shpenzuara nga une kandidati i pavur Gjergj Aleksander BOJAXHI per Fushaten Zgjedhore sipas Vendimit te KQZ Nr. 969 date 10.08.2015.

Gjergj Aleksander BOJAXHI

Tirane , Nentor 2015

## LETËR E DREJTIMIT

Drejtuar Z.Neshat MAZE  
Ekspert Kontabel i Regjistruar

Tirane me, Nentor 2015

Kjo leter e deklarimeve jepet ne lidhje me kryerjen e auditimit tuaj ligjor te fondeve te perfituara dhe te shpenzimeve te kryera nga Kandidati i Pavarur Gjergj Aleksander BOJAXHI ne fushaten zgjedhore per zgjedhjet per organet e qeverisjes vendore te dates 21.06.2015 me qellimin e shprehjes se nje opinioni ne se fondet e perfituara dhe te shpenzimeve te kryera japin nje pamje te vertet dhe te sinqerte.

Ne e njohim pergjegjesin tone per paraqitjen e vertet te regjistrave te posacem dhe te pasqyrave financiare. ne pajtim me Ligjin nr.10019, date 29.12.2008 i ndryshuar "Kodi Zgjedhor i Republikes se Shqiperise" si dhe menyren e raportimit financiar te tyre.

Ne konfirmojme ,sipas njohurise dhe besimit tone me te mire, deklarimet ne vijim:

Nuk kane ekzistuar paregullsi te cilat mund te implikojne drejtimin ose te punesuarit me nje rol te rëndesishem ne kontrollin e tyre, qe mund te kene nje efekt material ne regjistrat e paraqitur.

Ne ju kemi vene ne dispozicion te gjithe librat e llogarive dhe dokumentacionin mbeshitetes per fondet e perfituara dhe shpenzimet e kryera gjate fushates zgjedhore  
Ne konfirmojme plotesine e informacionit te dhene ne lidhje me identifikimin e paleve te lidhura.

Regjistrat e posacem dhe pasqyrat financiare nuk kane anomali materiale, perfshire ketu dhe dokumente te paregjistruara.

Per administrimin e fondeve eshte vepruar ne perputhje me kerkesat e Ligjit nr 10019 date 29.12.2008 dhe ndryshuar me ligjin nr 74/2012 date 19.07.2012 dhe ligjin nr 31/2015 date 02.04.2015 "Kodi Zgjedhor i Republikes se Shqiperise" dhe neneve perkatese te tij. Nuk ekziston asnje papajtushmeri me kerkesat e autoriteteve rregulluese qe ne rast papajtueshmerie. mund te kefe efekte material ne regjistrat e posacem dhe pasqyrat financiare.

Nuk ka ngjarje te mevonshme tej mbylljes se regjistrave te posacem dhe pasqyrave financiare te cilat te kerkojne rregullimin e paraqitjes se tyre

Kandidati i Pavarur

Gjergj BOJAXHI